



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

AUTORIZIM

PËR LËSHIMIN E PLOTFUQISË PËR NËNSHKRIM MARRËVESHJEJE

Në mbështetje të nenit 92, gërma "ë" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 5 pika 2, nenit 6, pika 1 dhe pika 3 shkronja "a" të ligjit nr. 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", autorizoj Sh.T.Z. Edi Rama, Kryeministër dhe Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme për lëshimin e plotfuqisë për Znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë, për nënshkrimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, si huamarës, Bankës së Shqipërisë, si agjent për huamarrësin, dhe Bashkimit Evropian, si huadhënës, për ndihmën makrofinanciare për Shqipërinë, në shumën prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) eurosh.

Lëshimi i plotfuqisë të realizohet njëkohësisht me plotësimin e mangësive procedurale, të evidentuara në shtojcën bashkëlidhur këtij Autorizimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet, për lëshimin e plotfuqisë, si dhe të përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë sipas këtij Autorizimi, nuk mund të delegohen tek asnjë autoritet apo organ tjetër publik dhe ushtrimi i tyre nga autoritetet e përcaktuara në këtë autorizim është i detyrueshëm sipas ligjit.

Nr. autorizimit 3272

Tiranë, më 28.09.2020

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

